



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:155195

Datë: 09.01.2025

Numri i dokumentit: 06689002

C.nr. 1922/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Haxhi Xhemajli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, A. Sh. nga Peja, të cilin e përfaqëson i autorizuari A. R., avokat në Pejë, kundër të paditurës, Komuna e Pejës - Drejtorati Komunal i Arsimit, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Sh.M.B, avokate në Pejë, me objekt kontesti: Kompensim i dëmit – pjesës së pagës, me vlerë të kontestit: ... euro, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancën e mbajtur më datë 19.12.2024 mori, ndërsa me datë 09.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET NË TËRESI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A.Sh. nga Peja, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Pejës, Drejtorati Komunal i Arsimit, që paditësit A.Sh nga Peja, në emër të diferencës së papaguar në pagë për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri me 01.02.2023, t'ia paguaj diferencën e pagës neto në shumën prej ... euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë, në emër të kontributit pensional shumën prej ... euro, në emër të tatimit në pagë shumën prej ... euro, dhe në emër të kontributit sindikal shumën prej ... euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej ... euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi A.Sh. ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë ..., kundër të paditurës Komuna e Pejës – Drejtorati Komunal i Arsimit, me objekt kontesti, kompensim i dëmit – pjesës së pagës, me vlerë të kontestit ... euro.

Pala paditëse përmes të autorizuarit të tij, në padi, dhe precizimin e kërkesës së saj, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Pejës - Drejtorati Komunal i Arsimit, që paditësit A.Sh. nga Peja, për periudhën nga data 01.01.2020 deri me datën 01.02.2023, t'ia paguan diferencën e pagave neto shumën prej ... euro, në emër të kontributit sindikal shumën prej ... euro, në shumën e përgjithshme prej ... euro, me kamat ligjore prej 8% nga dita e arritjes se secilës kërkesë për pagës veç e veç e deri na pagesën definitive të detyrimit, në emër të ndryshimit në kontribute pensionale shumën prej ...

euro, si dhe në emër të ndryshimit të tatimit në pagë shumë prej ... euro. Me tej ka shtuar se, baza juridike e këtij kontesti është vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33, të datës 29.08.2008, në të cilin vendim është thirrur edhe vet përfaqësuesja e palës së paditur, ashtu që konsiderojmë se paditësit i takon diferenca në paga - të ardhura personale që i janë zbritur pa bazë ligjore nga e paditura, duke përfshirë periudhën kohore nga data 01.01.2020, deri me datën 01.02.2023. Gjithashtu ka theksuar se, nuk ka kurrfarë baze ligjore për të kundërshtuar bazueshmërinë e padisë dhe kërkesës së saj. Paditësi është i licencuar dhe është në marrëdhënie pune pa ndërprere nga viti ..., dhe se kontratat e punës nga Drejtorati Komunal i Arsimit (DKA), ju kanë vazhduar për çdo vit dhe në heshtje sipas fuqisë ligjore e ka fituar të drejtën për punësim të përhershëm deri në pension në harmoni me dispozitat e Ligjit të Punës. Pra, që padia dhe kërkesë padia e paditësit janë të bazuara në ligjet e aplikuara, aktet nënligjore të organeve kompetente të Republikës së Kosovës e vërteton edhe mendimi juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 214/2023, që mban datën 05.10.2023, ashtu që në bazë të të lartcekurave gjykatës i propozon që të aprovoj padinë dhe kërkesën e saj si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar – specifikuar, si në vijim: për taksën gjyqësore shumë prej ... euro, për përpilimin e padisë shumë prej ... euro, për përfaqësim për tri seanca gjyqësore shumë prej ... euro sipas tarifës së OAK, dhe për ekspertizën financiare shumë prej ... euro.

Pala e paditur me përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare nëpërmes të autorizuarës së saj, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj si të pabazuar, duke theksuar se, paditësi në shkresat e lëndës ka ofruar dëshmi që është i kualifikuar si Master i Arteve në Transport dhe Telekomunikacion, dhe mbi bazën e këtij kualifikimi në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës i njëjti nuk jep mësim për orët në të cilat është i kualifikuar, andaj në përputhje me vendimin e Qeverisë sipas të cilit rritja e pagave bazohet në kualifikimin për çka mësimdhënësit ushtrojnë detyrat e tyre, i njëjti nuk ka të drejtë në ngritjen e pagës sipas licencimit në bazë të licencës së ofruar nga paditësi në shkresat e lëndës, e njëjta ka datë të skadimit dhe duke pas parasysh faktin se paditësi e ka barrën e të provuarit i njëjti nuk ka ofruar prova të mjaftueshme që dëshmojnë se jep mësim në një lëndë për çka është i kualifikuar dhe i licencuar. Ka shtuar se, dhe sikur paditësi t'i plotësonte kriteret sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjithsesi kërkesë padia do t'i tejkalojë shumat të cilat do i përkisnin, ngase i njëjti sipas provës që gjendet në shkresat e lëndës ka diplomuar me datën 22.09.2020, që do të thotë se para kësaj date edhe ashtu nuk do t'i takonte ngritja prej 35% siç e parasheh vendimi i Qeverisë i datës 29.08.2008, andaj duke u mbështetur në të lartcekurat, kërkoj nga gjykata që pas administrimit të provave ta refuzoj në tërësi kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar – specifikuar, si në vijim: për përgjigje në padi shumë prej ... euro, si dhe për tri seanca gjyqësore të mbajtura shumë prej .. euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej ... euro.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Kontratën e punës me numër të protokollit

... e datës ...; Kërkesën e datës ...; Ekspertizën financiare nga lëmi financiar e datës ...; Vendimin i Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33 i datës 29.08.2008; Aktvendimin mbi licencimin e mësimdhënësit me numër protokollit ...; Licencën e mësimdhënësit numër ...; Diplomën Master për A.Sh., të lëshuar nga Kolegji i Shkencave të Aplikuara “Tempulli” e datës ..., me numër ..., si dhe deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqës.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim: LPK), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsye se:

Në bazë të kontratës se punës me numër të protokollit ... e datës ..., gjykata ka provuar faktin se paditësi ka themeluar marrëdhënie juridike të punës për kohë të caktuar nga data ... deri me ..., duke u caktuar në detyrat e punës në vendin e punës Mësimdhënës për lëndën e Matematikës dhe TIK-ut, pranë Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “...” në ... me pagë bazë - bruto në lartësi prej ... euro.

Në bazë të kërkesës me numër ... të datës ..., gjykata ka provuar faktin se, paditësi fillimisht i është drejtuar me kërkesë Drejtoratit Komunal të Arsimit, përkatësisht drejtorit B.A. për pagesën e shtesës në përputhje me kontratën e punës.

Në bazë të Aktvendimit mbi licencimin e mësimdhënësit me numër protokollit ..., i datës ... të lëshuar nga Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në vijim: MASHT), gjykata ka provuar faktin se paditësi i është pranuar kërkesa për licencim, dhe atë për periudhën e vlefshmërisë nga data ... deri me datën

Në bazë të licencës se mësimdhënësit numër ..., gjykata ka provuar faktin se paditësi është licencuar me licencë të karrierës nga MASHT.

Në bazë të diplomës se nivelit Master të fituar nga ana e paditësit, gjykata ka provuar faktin se paditësi A.Sh., ka fituar gradën Master i Arteve në Transport dhe Telekomunikacion, të lëshuar nga Kolegji i Shkencave të Aplikuara “Tempulli” e datës ..., me numër

Gjykata me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesëpadisë, me propozimin e të autorizuarit të paditësit ka nxjerrë ekspertizën nga lëmia e financave, dhe për ekspert ka caktuar ekspertin gjyqësor nga lëmia e financave nga lista e ekspertëve të KGJK, M.M.. Në bazë të detyrave të dhëna përmes Aktvendimit C.nr. ..., të datës ..., si dhe bazuar në përlllogaritjet e kryera dhe materialet e ekzaminuara, eksperti ka konstatuar se diferenca e detyrimeve të përlllogaritura për periudhën 01.01.2020 deri më 01.02.2023, është si në vijim: 1) ndryshimi në pagë neto: ... euro; 2) ndryshimi në kontributet pensionale ... euro; 3) ndryshimi në tatimin në pagë ... euro; dhe 4) ndryshimi në kontributin sindikal ... euro, gjithsejtë në shumën prej ... euro. Gjykata e mori në tërësi ekspertizën si të bazuar dhe relevante pasi që e njëjta është në harmoni edhe me provat që janë në shkresat e lëndës, si dhe i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën

e njohurive profesionale dhe arsyeve të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Gjykata për të vendosur lidhur me pretendimet e palës paditëse në këtë çështje juridike kontestimore, se pari analizoj bazën ligjore, duke marr për bazë fillimisht nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i cili përcakton se, *“I punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune,”* ndërsa me nenin 10 paragrafi 4, përcaktohet se, *“Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.”* Me tej, me paragrafin 5 të këtij neni, parashihet se, *“Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.”*

Po ashtu, në bazë të Vendimit nr. 01/33, të datës 29.08.2008, përkatësisht në piken 1 të këtij vendimi është përcaktuar se, *“Nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtoret (zëvendësdrejtoret) dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të licencimit,”* kurse në piken 3 të këtij vendimi parashihet se, *“Ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtoret (zëvendësdrejtoret) dhe bashkëpunëtorët profesionale në nivelin fillor dhe atë mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës.”* Dhe, për me tepër, më piken 4 të të njëjtit vendim, përcaktohet shprehimisht se, *“Mësimdhënësit, drejtoret (zëvendësdrejtoret) dhe bashkëpunëtorët profesionalë, të pajisur: 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%.”*

Gjithashtu, në bazë të Mendimit Juridik nr. 214/2023, i datës 05.10.2023, është sqaruar aspekti i kërkesave të mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit, ku përcaktohet se, *“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi behet sipas kushteve dhe kriterëve të të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/33, të datës 29.08.2008.”* Në të njëjtën mënyrë, është përcaktuar në arsyetimin për piken I të këtij mendimi juridik, përkatësisht në paragrafin 5 të tij, i cili parasheh se, *“Qëndrimi Gjykatës Supreme të Kosovës është së në rastet e tilla, çështja e kompensimit të mësimdhënësve mbi bazën e kualifikimit (licencimit) duhet të trajtohet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me vendimin e qeverisë, kjo pasi që ky vendim në fuqi deri me datë 06.02.2023, pastaj mënyra se si është rregulluar çështja e ngritjes së pagës sipas kualifikimit dhe obligimet që janë përcaktuar me vendim, dallojnë nga mënyra si është trajtuar kjo çështje me kontrate kolektive të arsimit.”*

Gjykata duke marr për bazë gjendjen faktike të vërtetuar dhe provat e administruara në këtë çështje juridike kontestimore, erdhi në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar, për faktin se, e drejta në kompensimin e shtesës mbi bazën e gradës të përcaktuar me kontratën e punës midis paditësit dhe të paditurës është një e drejtë e fituar, dhe si e tillë nuk mund të kufizohet apo të mohohet, përveç në rrethanë të ndonjë qëllimi legjitim nga ana e punëdhënësit, dhe se kjo e drejtë e fituar në rastin konkret, në përputhje me ligjin e aplikueshëm nuk mund të kufizohet apo mohohet përmes veprimit të njëanshëm të të paditurës. Në këtë rast, nuk mund të këtë zbatim retroaktiv të ligjit në dëm të palës në një marrëdhënie juridike të punës, dhe për me tepër, ndalimi i zbatimit “retroaktiv” është element qenësor i sigurisë juridike dhe se

mungesa e sqarimit përkitazi me zbritjen e shtesës nga ana e të paditurës, e bën këtë veprim të të paditurës të jetë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike. Në anën tjetër, një llogaritje e tillë e shtesës së punës përben edhe cenim të së drejtës së pronës. Pra, kjo paraqet shkelje të nenit 46 (Mbrojtja e pronës) të Kushtetutës së Kosovës, dhe nenit 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, për shkak të shkeljes së arsyeshmërisë dhe të proporcionalitetit të zvogëlimit të pasurisë. Në këtë mënyrë, ulja e pagës (gradës) pa një arsyetim të detajuar, ka ndikuar në zvogëlimin e të hyrave tek paditësi, të cilit i është mohuar e drejta në shtesën në bazë të kontratës së punës, të cilën e ka fituar gjatë viteve të kaluara, përkatësisht ka ndikuar në cenimin e pronës. Nga ky përcaktim gjykata vlerëson se, arsyet për ulje pagash duhet të jenë shumëfish më të qëndrueshme se sa arsyet për rritje pagash, ngase të parat pakësojnë një të drejtë ekzistuese, e cila e drejtë i është njohur paditësit nga ana e të paditurës përmes themelimit të marrëdhënies së punës. Sipas nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i punësuar i caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune, dhe në këtë mënyrë rrjedh detyrimi për palët nënshkruese që t’ju përmbahen kushteve të cilat dalin nga një marrëdhënie e tillë. Për me tepër, marrëdhënia e punës është një marrëdhënie që rregullohet juridikisht përmes kontratës së punës. Me konkretisht, kontrata e punës përfaqëson një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhënien e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve nënshkruese. Pra, përmes sajë punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të punëdhënësit, në kundërvlerë të pagës mujore.

Gjykata vlerëson gjithashtu se, duke marr për bazë faktin se paditësi është në marrëdhënie pune për një periudhë me shumë se 10 (dhjetë) vite tek e paditura, gjë që është vërtetuar përmes deklarimeve të ndërgjyqësve gjatë kësaj procedure, konsiderohet se sipas vet fuqisë së ligjit i është njohur e drejta për marrëdhënie të përhershme të punës. Një e drejtë e tillë paditësit i njihet edhe përmes Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, konkretisht nenit 10 paragrafi 5, i cili ka paraparë se, kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore. Prandaj, me vetë faktin se e paditura është pajtuar që nga paditësi të pranoj shërbimin (mësimdhënien) sipas kontratës me kohe të caktuar, të cilën e ka vazhduar në mënyrë të heshtur për çdo vit, konsiderohet se të njëjtit i është njohur kjo e drejtë që ai të jetë në marrëdhënie të përhershme pune me të paditurën. Një konstatim i tillë është dhënë edhe përmes Qëndrimit Parimor të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 152/2023, i datës 26.07.2023, ku qartësohet se, *“Ligji i punës në tërësinë e tij, nuk parasheh mënyrë tjetër të themelimit të marrëdhënies së punës përpos se me kontratë të punës, e cila sipas nenit 10 të këtij ligji mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar, periudhë të caktuar dhe për punë dhe detyra specifike. Në kuadër të nenit 10, paragrafi 5 të këtij ligji është përcaktuar shtesë kur kontrata është lidhur për kohë të caktuar por që ripërtërihet në mënyrë të qartë apo vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se 10 vite, do të konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.”* Gjykata rithekson se, e drejta e paditësit për kompensim të diferencës së papaguar në pagë, për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri me 01.02.2023, është një e drejtë e fituar, dhe si e tillë i njihet paditësit duke marr për bazë kornizën ligjore, përkatësisht Vendimin nr. 01/33, të datës 29.08.2008, dhe atë në vlerën prej 27%. Për me tepër, edhe GJEDNJ në rastin *N.K.M. v. Hungary*, këtë të drejtë e ka përcaktuar si të drejtë të fituar që garantohet me ligj në

këmbim të shërbimit të dhënë, (paragrafi 40). Pra, në këtë rast, duke marr për bazë provat e administruara, deklaratimet e ndërgjyqësve, dhe bazën ligjore të theksuar me lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve të të autorizuarës së palës se paditur se paditësi nuk posedon kualifikimin përkatës për mësimdhënie në lëndën për të cilën aktualisht është i angazhuar, për gjykatën një pretendim i tillë nuk është i bazuar për faktin se, kjo bien ndesh me vullnetin e deklaruar të palëve në momentin kur e kanë nënshkruar kontratën e punës. Një kualifikim të tillë, “Baçelor i Komunikacionit Rrugor dhe Transportit” paditësi e ka pasur edhe kur e paditura e ka angazhuar si mësimdhënës për lëndën e matematikës, dhe ky aspekt është dashur të merret për bazë në momentin e nënshkrimit të kontratës së punës. Nga kjo rezulton se, kjo rrethanë, për paditësin ka krijuar “pritje legjitime” për të fituar pasuri. Dhe, meqenëse, në këtë rast ekziston e drejta e paditësit, e cila është e drejtë konkrete, dhe që buron nga një bazë në ligjin e aplikueshëm, konsiderohet se i njihet një e drejtë që i nënshtrohet fushëveprimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, përkatësisht testit që buron nga ky nen, por edhe nenit 55 të Kushtetutës, sipas të cilëve, duhet të vlerësohet nëse ndërhyrja/kufizimi i gëzimit paqësor të pronës, (a) është i përcaktuar me ligj; (b) ndjek një qëllim legjitim; dhe (c) është proporcional me qëllimin e ndjekur. Përderisa për gjykatën nuk është kontestues fakti se veprimi i të paditurës, përmes ndalimit të shtesës në bazë të gradës, ndërhyrja/kufizon të drejtën e fituar, përkatësisht gëzimin paqësor të pronës, gjykata vlerëson se e paditura është në detyrim për kompensim ndaj paditësit sipas periudhës kohore të theksuar me lartë, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson gjithashtu se, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, nuk mund të bëhet për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar, dhe që me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut, institucioni ka për detyrë t’i kushtojë kujdes, para së gjithash, raportit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtoj mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim sa më të vogël. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, nuk është përmbushur asnjë nga këto kritere, dhe ndërhyrja/kufizimi i të drejtës së paditësit për realizimin e shtesës në emër të gradës, nuk është argumentuar dhe nuk ndjek asnjë qëllim legjitim nga ana e të paditurës.

Sa i përket vendimit lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 382 të LMD, dhe paragrafin X (dhjetë) të Mendimit Juridik për Kamatën nr. 265/2020 të datës 01.12.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke ju referuar datës së parashtrimit të padisë, përkatësisht datës 14.07.2021.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u mbështetur në nenin 452 paragrafi 1 të LPK i cili përcakton se, “*Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore.*” Në këtë rast gjykata i ka aprovuar në tërësi shpenzimet e procedurës të kërkuara nga i autorizuari i paditësit, lartësia e të cilave i referohen përpilimit të padisë në shumën prej ... euro, për taksën për padi shumën prej .. euro, për përfaqësim për tri seanca gjyqësore nga ... euro për secilën seancë, në shumën prej ... euro sipas tarifës së OAK, si dhe për ekspertizën financiare shumën prej ... euro, në shumën e përgjithshme prej ... euro.

Nga arsyet e theksuara me lartë, si dhe bazuar në nenin 143 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:155195; C.nr. 1922/21; datë 09.01.2025

Gjyqtari

Haxhi XHEMAJLI

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.